



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 33, datë 18.1.2017

P Ë R

**MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA
NGA DREJTORIA PËR TË DREJTËN E AUTORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 157, të ligjit nr.35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave për shërbimet që ofron Drejtoria për të Drejtën e Autorit, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Tarifat e përcaktuara me këtë vendim do të paguhen nga persona fizikë dhe juridikë, që kërkojnë nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit, pranë Ministrisë së Kulturës, kryerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Pagesat e parashikuara në këtë vendim do të kryhen pranë llogarisë së Ministrisë së Kulturës, në degën e thesarit dhe do të derdhen në buxhetin e shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I KULTURËS

MIRELA KUMBARO FURXHI

Aneksi 1

Nr.	Shërbimi	Tarifa
1	Regjistrimi i fonogramit shoqëruar me kontratën e kalimit të së drejtës së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 tituj b) Nga 21 deri në 50 tituj c) Nga 51 deri në 100 tituj ç) Më shumë se 100 tituj	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
2	Regjistrim i së drejtës së autorit për programet kompjuterike së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 programe kompjuterike b) Nga 21 deri në 50 programe kompjuterike c) Nga 51 deri në 100 programe kompjuterike ç) Më shumë se 100 programe kompjuterike	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
3	Regjistrim i së drejtës së autorit për krijimet fotografike së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 vepra fotografike b) Nga 21 deri në 50 vepra fotografike c) Nga 51 deri në 100 vepra fotografike ç) Më shumë se 100 vepra fotografike	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
4	Regjistrim i së drejtës së autorit për krijimin origjinal nga autori/autorët së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 vepra b) Nga 21 deri në 50 vepra c) Nga 51 deri në 100 vepra ç) Më shumë se 100 vepra	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
5	Lëshimi i dublikatit të certifikatës	300 lekë
6	Lëshimi i kopjeve të ekstraktit të regjistrimit të së drejtës së autorit	500 lekë
7	Modifikimi i të dhënave, publikimi i modifikimit të dhënave të këtyre ndryshimeve ose korrigjimi i të dhënave si dhe publikimi i korrigjimit të të dhënave në regjistrin e të drejtës së autorit	2000 lekë ¹
8	Kryen veprimtari profesionale dhe administrative dhe jep asistencë teknike dhe shkencore në lidhje me karakterin origjinal të produkteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, me kërkesë të organeve të hetimit penal dhe me shpenzime të të pandehurve, në qoftë se fajësia e tyre provohet	5000 lekë
9	Aplikimi për licencimin ose rilicencim të organizatave si agjenci të administrimit kolektiv	300 000 lekë
10	Kryen, me kërkesë dhe kundrejt pagesës, hetim administrativ, në favor të palëve të interesuara	10 000 lekë

¹ Publikim në faqen web zyrtare të DDA-s,

11	Administrimi dhe ruajtja e fondit të veprave	500 lekë
12	Regjistrimi i personave fizik apo juridikë të autorizuar lidhur me kopjen private për të drejtat e riprodhimit	0 (zero) lekë

NR.PROT.205/1
DATE 19.1.2017

MINISTRISË SË KULTURËS
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

